

VEÇVENDOSHËM PËR FERIZAJ-  
GJYKATË THEMELORE FERIZAJ - URGJIMI

### NË EMËR TË POPULLIT

03.10.2017

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-**

**divizioni penal.** gjyqtari individual Mustaf Tahiri, me bashkëpunëtorin Profesional [REDAKTUE] në lëndën penale kundër të pandehurit [REDAKTUE] nga [REDAKTUE] rr. " [REDAKTUE]", i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/I.nr.2730-3/14 të dt.14.06.2016 për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga nen 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e prokurorisë për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me dt. 16.06.2017 mori këtë:

#### A K T G J Y K I M

**PRANOHET** kërkesa e PPK në Ferizaj PP/I.nr.2730-3/14 të dt.14.06.2016 dhe kjo gjykatë jep këtë:

#### URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [REDAKTUE] me vendbanim në Ferizaj rr. " [REDAKTUE]", i lindur më [REDAKTUE] në të njëtin vend, nga i ati [REDAKTUE], e ëma [REDAKTUE] e gjinisë [REDAKTUE], i gjendjes së mesme ekonomike, vozitës, shqiptar, ka të kryer shkollën e mesme, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal [REDAKTUE]

#### ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 17.11.2014 rrëth orës 16:45, në fshatin Slivovë, komuna e Ferizajt, duke drejtuar automjetin e markës " Golf ", ngjyrë e bardhë, me targa të regjistrimit: [REDAKTUE] në kundërshtim me nenin 54.1 të LSKRR-së, nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve, në atë mënyrë që nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe kushteve në rrugë, ashtu që gjersa fëmija- këmbësorja [REDAKTUE] me një karrocë ishte duke kaluar rrugën nga ana e majtë në të djathtë i pandehuri në pamundësi për të ndal veturën me pjesën e përparme të anës së majtë e ka goditur të dëmtuarën [REDAKTUE] e cila është rrëzuar në tokë, me ç'rast nga kjo goditje e dëmtuara ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe atë: ndrydhje të

indeve të buta në regjionin e shputës së këmbës së djathtë, me pasoja të përkohshme për shëndetin, të përshkruara si në ekspertizën e ekspertit mjeko ligjor të datës 18.02.2016, -

**me ç 'rast ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.**

Prandaj gjykata në bazë të nenit 4.7,17.23.41.46.73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së

**GJ Y K O N**

Me dënim në gjobë në shumë prej 300 (treqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rastë se dëniimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 47 të KPK-së, i njëjtë do ti zëvendësohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

E dëmtuara [REDACTED] dhe përfaqësuesi i saj ligjor nga fsh. [REDACTED], komuna e [REDACTED] për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

Gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale në shumë prej 90.88 euro si dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20 € në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/I.nr.2730-3/14 të dt.14.06.2016 ka akuzuar të pandehurin [REDACTED] për vepër penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP/I.nr.2730-3/14 të dt.14.06.2016, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallximi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si mendimin dhe konstatimin e ekspertit të komunikacionit rrugor inxh. [REDACTED] të dt.23.05.2016, mendimin dhe konstatimin e ekspertit të mjekësisë ligjore dr. [REDACTED] dt.18.02.2016, fotografitë dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë, konstatoj se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në bazë të nenit 463 të KPP-së të dëmtuarën [REDACTED] dhe përfaqësuesi i saj ligjor për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale çshtë marrë në baze të nenit 450 dhe 451 të KPPK-së dhe atë në emër të Ekspertizës së komunikacionit në shumën prej 40.88€ dhe në emër te ekspertizës Mjeko ligjore prej 20 €, ndërsa në emër të paushallit gjyqësore shumën prej 20 € paushallit është marrë në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPP-së.


**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-  
divizioni penal, P.nr. 535/16, dt.16.06.2017**

Bashkëpunëtori Profesional,

Gj y q t a r

**Faredin Ilazi**

**Mustaf Tahiri**



**UDHËZIM JURIDIK:**

Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate përmes kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor merrë formën e prerë dhe dënimini i shqiptuar ekzekutohet.